



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/116
Datë: 28.12.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Rishikimin e Ligjeve në Sektorin e Energjisë.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria Vlada-Government**

**Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**

**KONCEPT DOKUMENTI
PËR RISHIKIMIN E LIGJEVE NË SEKTORIN
E ENERGJISË**

Nëntor, 2022

Përmbajtja:

1.Përmbledhje e Koncept Dokumentit.....	3
2.Hyrje	7
3.Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....	8
4.Kapitulli 2: Objektivat	23
5.Kapitulli 3: Opsionet.....	25
6.Opsioni 1- Ruajtja e gjendjes Status quo (asnjë ndryshim)	25
7.Opsioni 2 - Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit (Amandamenti i legjislacionit ekzistues).....	26
8.Opsioni 3 – Hartimi i akteve të reja ligjore.....	26
9.Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	29
10.Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi.....	34
11.Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	35
12.Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	36
13.Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet	43
14.Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm.....	44
15.Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	45
16.Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik.....	46
17.Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	50
18.Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	55
19.Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore	59

Përmbledhje e Koncept Dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për Rishikimin e Ligjeve në Sektorin e Energjisë
Ministria bartëse	Ministria e Ekonomisë, <i>Departamenti i Energjisë</i>
Personi kontaktues	Adnan Preniqi UD. Udhëheqës i Divizionit të Politikave të Energjisë Adnan.preniqi@rks-gov.net
PSO 2022-2025	Koncept Dokumenti për rishikimin e ligjeve në sektorin e energjisë është i paraparë në Planin Strategjik dhe Operacional për periudhën 2022-2025 në objektiven operacionale 1.11
Prioriteti strategjik	1) Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031; Objektivat: • <i>Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit;</i> • <i>Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme;</i> • <i>Rritja e Eficiencës së Energjisë (EE);</i> • <i>Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut;</i> • <i>Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve dhe zhvillimi i fuqisë punëtore.</i> 2) Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2021-2025 pika 2.14.1.; 3) Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për periudhën 2022-2026; 4) Agjenda e Reformës Evropiane (ERA II); 5) Koncept Dokumenti adreson rishikimin e kornizes ligjore të paraparë në prioritetin 2.14.1. të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2021-2025.

Vendimi	
Çështja kryesore	Më 25 tetor 2005, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar Traktatin për themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE), duke u bërë kështu Palë Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë. Si rezultat i anëtarësimit, Kosova obligohet që të përmbushë kërkesat që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë, me

	theks të veçantë tek transpozimi dhe adaptimi i të gjitha dispozitave ligjore konform direktivave evropiane, apo “acqui” të energjisë. Në vitin 2019-të, Bashkimi Evropian (BE), në vazhden e veprimeve për t’u larguar nga shfrytëzimi i burimeve fosile dhe i respektimit të zotimeve të dala nga Marrëveshja e Parisit, ka miratuar Pakon e Energjisë së Pastër. Kjo Pako përbëhet nga një sërë aktesh legjislative që rregullojnë Efiçencën e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), tregjet e energjisë elektrike, menaxhimin dhe administrimin e krizave për furnizim me energji elektrike dhe qeverisje. Objektiva kyçe e Pakos së energjisë së pastër është dekarbonizimi i sektorit të energjisë dhe ekonomisë, fuqizimi i të drejtave të konsumatorit, rritja e nivelit të gjenerimit të energjisë nga BRE, dhe stimulimi i projekteve inovative. Veçanërisht, kjo Pako dallohet me vendosjen e objektivave ambicioze mbi përfaqësimin e pjesës së Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe caqeve të Efiçencës së Energjisë (EE). Të drejtat e konsumatorit rridefinohen në kuadër të tranzicionit energjetik dhe kemi një theks të veçantë tek zgjerimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe menaxhimin e krizave dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Në nëntor të vitit 2021, në kuadër të takimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, përmes vendimit 2021/13/MC-EnC, Palët Kontraktuese u pajtuan rreth obligimit për transpozimin e dispozitave ligjore të Direktivës mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE), Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike BE 2019/941 dhe Rregullorja mbi Qeverisjen e Bashkimit të Energjisë dhe Veprimet Klimatik Bashkimi Evropian (BE) 2018/1999 në kuadër të legjislacionit primar. Rrjedhimisht, nëpërmjet transpozimit të dispozitave përkatëse ligjore pritet të njëjtësohet baza e nevojshme për dekarbonizimin e sektorit të energjisë dhe krijimit të një sistemi modern, të pastër dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike.
Përmbledhje e konsultimeve	Gjatë procesit të hartimit të këtij Koncept Dokumenti, grupi i punës ka zhvilluar konsultimet dhe komunikimet e mëposhtme: Në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, Grupi Punues ka mbajtur disa takime. Poashtu me datë 31.05.2022, është mbajtur një takim me publikun (OJQ) me qëllim të njoftimit për fillimin e hartimit të Koncept Dokumentit dhe objektivat kryesore që synohen përmes këtij Koncept Dokumenti. Koncept Dokumenti për rishikimin e ligjeve të sektorit të energjisë fillimisht u është dërguar me e-mail të gjitha palëve të identifikuara të interesit për konsultim paraprak me datë 05.08.2022 në një afat prej 15 ditë pune.

	Pas përfundimit të konsultimit paraprak, koncepti dokumenti për rishikimin e ligjeve të sektorit të energjisë është publikuar për konsultim me publikun në platformën elektronike për konsultimet me publikun më datë 07.09.2022 dhe ka qenë i hapur për komente deri më datë 27.09.2022. Gjatë procesit të konsultimit paraprak janë pranuar komente nga përfaqësuesi i KOSTT-it në grupin punues për plotësime në tabelën 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit tek pjesa Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala dhe pjesa Efektet me të cilat është e lidhur pala, dhe po ashtu edhe Tek Opsioni 3 – Hartimi i akteve të reja ligjore të përmirësohet një afat kohor dhe plotësim shtesë lidhur me obligimet e OST-së Ndërsa gjatë procesit të diskutimit me publikun nuk kemi pranuar ndonjë koment, vërejtje apo sugjerim nga institucionet qeveritare apo palët e interesit.
Opsioni i propozuar	Hartimi i akteve të reja primare ligjore ashtu që të përfshihen dispozitat ligjore të Pakos së Energjisë së Pastër sipas vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë. Përkatësisht, tri ligjet kryesore që rregullojnë sektorin e energjisë: Ligji për Energji, Ligji për Energjinë Elektrike, dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë – duhet të ndryshohen dhe aprovohen si ligje të reja nga organi ligjvënës.

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Opsionet e konsideruara mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës si dhe nga donacionet e jashtme.
Ndikimet ekonomike	Rritje të konkurrencës në mes të prodhuesve, furnizuesve dhe tregtarëve respektivisht do të ndikojë në rritje të numrit të vendeve të reja të punës si dhe tërheqje të investimeve të huaja dhe nga diaspora Kosovare.
Ndikimet shoqërore	Fokusi primar do të jetë në mirëqenien e qytetarëve duke trajtuar komponentën mbi definimin dhe administrimin e fondit për konsumatorët në nevojë. Përmirësim në shëndetin e qytetarëve si rrjedhojë e investimeve në energji të gjelbër dhe eliminimi gradual i shfrytëzimit të linjtit.
Ndikimet mjedisore	Përfitimet mjedisore do të jenë të mëdha për shkak të zvogëlimit të emetimeve të ndotësve, duke siguruar përfitime edhe në fusha që ndërlidhen, siç është shëndetësia. Në të njëjtën kohë, zvogëlimi i emetimeve të CO ₂ dhe gazrave tjerë serrë do të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Ndikimet ndër-sektoriale	Si rezultat i investimeve të konsiderueshme në sektorin e Energjisë së Ripërtëritshme, industrisë do t'i nevojiten punëtorë të aftë dhe të trajnuar, duke i rritur mundësitë për zhvillimin e aftësive dhe aftësimin profesional.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Ngarkesa administrative parashihen në kuadër të licencimit për aktivitete të ndryshme tek Rregullatori; ngarkesat administrative të aplikuara nga OST-ja dhe OSSH-ja në përputhje me Metodologjitë e Taksave për Kyçe dhe të tjera.
Testi i NVM-ve	Do të ketë ndikim pozitiv tek NVM-të në dy drejtime. Së pari, NVM-të do të mund të planifikojnë biznesin e tyre dhe të bëjnë investime të reja me më pak rreziqe duke pasur parasysh besueshmërinë e burimeve të reja të energjisë. Së dyti, disa nga NVM-të ekzistuese si dhe investorët e rinj do ta kenë mundësinë të investojnë në biznese të reja në sektorin e energjetikës. Mundësitë ndërliken me rolin e ri të Komuniteteve të Energjisë që kanë potencial të bëjnë më tërheqës mundësinë e grupeve tradicionalisht të papërfshira aktivisht në sektorin e energjisë që të investojnë.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti nga Qeveria e Republikës së Kosovës një grup i ri pune do të krijohet nga ME-së, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit, për të filluar punën për zbatimin e opsionit të rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti, pra hartimit të Ligjeve të reja primare të Energjisë, përkatësisht Ligjin e Energjisë, Ligjin e Energjisë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
Afatmesëm	Pas hartimit të Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, miratimi i tyre do të paraprihet me konsultime publike. Kurse pas miratimit në Kuvend, do të organizohen takime, debate publike dhe punëtori për të promovuar ligjet e reja me qëllim të njohimit të institucioneve në nivel qendror dhe lokal për mënyrën e zbatimit të tij. Së fundi, do të fillohet me hartimin, plotësimin, dhe nxjerrjen e legjislacionit sekondar që del nga Pakoja e re e ligjeve të Energjisë. Hartimi i akteve të reja ligjore, përfshirë aktivitetet e caktuara në kuadër të Ligjit për Energji, Ligjit për Energji Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë do të hartohen dhe transpozohen më së largu gjatë fundvitit 2023. Pra, brenda këtij afati parashihet transpozimi i dispozitave – zhvillimi i aktiviteve informuese – që ndërliken me tregun e brendshëm të energjisë respektivisht zgjerimi i tregut dhe integrimi i plotë rajonal, zgjerimi i rolit të Rregullatorit, fuqizimi dhe zgjerimi i të drejtave të konsumatorëve, plani mbi përgatitjen dhe administrimin e

	krizave të furnizimit me energji elektrike, modernizimi i rrjetit të OST-së dhe OSSH-së, zhvillimi i konceptit mbi aplikimin e çmimeve konkurruese dhe të tjera. Aktivitetet që ndërlidhen me caqet e parapara në kuadër të Rregullores mbi Qeverisjen në Union të Energjisë dhe Veprimet Klimatik (BE) 2018/1999 dhe aktivitetet tjera të detajuara parashihet të zhvillohen pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti.
--	---

Hyrje

Tabela 1: Tabela me informacione të përgjithshme për Koncept Dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Rishikimin e Ligjeve në Sektorin e Energjisë
Ministria bartëse	Ministria e Ekonomisë, Departamenti i Energjisë Divizioni për hartimin e politikave të energjisë
Personi kontaktues	Adnan Preniqi UD. Udhëheqës i Divizionit të Politikave të Energjisë <u>Adnan.preniqi@rks-gov.net</u> 038/200-21-543
PVPQ	Koncept Dokumenti për rishikimin e ligjeve në sektorin e energjisë është i paraparë në Planin Strategjik dhe Operacional për periudhën 2022-2025 në rubrikën 1.11
Prioriteti strategjik	- Plani Strategjik Operacional për ME-në, përkatësisht: – Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm përmes rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve energjetike dhe Eficiencës së Energjisë (EE). 1.1. Rishikimi i kornizës ligjore dhe politikave energjetike bazuar në dëshmi, në përputhje edhe me legjislacionin acquis të BE-së. - Draft -Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031. - Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (PKZMSA), <i>Acquis</i> Kapitulli 15-Energjia tek pjesa narrative e PKZMSA. - Agjenda e Reformës Evropiane. - Programi për Reforma Ekonomike (PRE) – Masa 5: Zhvillimi i politikave të Eficiencës së Energjisë (EE) dhe BRE-ve në funksion të tranzicionit të gjelbër dhe Masa 6: Reformimi i tregut të energjisë.

Deri më tani, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit energjetik në Kosovë është bërë nëpërmjet kalimit të një pakoje ligjesh që janë kryesisht në përputhje me acquis e BE për fushën e energjisë. Raporti i Progresit për Kosovën në vitin 2021 konstaton se Republika e Kosovës ka një nivel të kënaqshëm të përgatitjes në fushën e energjisë. Kosova ka bërë progres me rritjen e investimeve në energjinë e ripërtëritshme, duke arritur objektivat e vitit 2020-të sipas Komunitetit të Energjisë.

Në përputhje me parimet dhe prioritetet e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, Strategjisë së Energjisë dhe Planit të Veprimit si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë të vitit 2021 parashihet transpozimi i Pakos së Energjisë së Pastër. Baza e re ligjore parashihet të sigurojë koherencën e politikave dhe përcaktimin e masave për të arritur objektivat e dekarbonizimit në mënyrën më ekonomike. Miksi energjetik në Kosovë dominohet në masë të konsiderueshme nga lëndët djegëse fosile, përkatësisht nga linjtë, i cili përveç të qenit një burim dominues i emetimit të gazeve serrë, shkakton dëme serioze shëndetësore dhe ndikon në rritje të rreziqeve mjedisore.

Qeveria e Kosovës ka treguar përkushtimin e saj drejt përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve dhe zotimit drejt arritjes së objektivave të dekarbonizimit deri në vitin 2050-të përmes qaveve kyçe të parapara në draft- Strategjinë e Energjisë për periudhën 2022-2031. Vizioni i kësaj strategjie parasheh zhvillimin ambicioz të kapaciteteve gjeneruese nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) duke ruajtur sigurinë e furnizimit me energji dhe duke vënë në pah rëndësinë e rritjes së nivelit të eficiencës dhe integritetit rajonal të tregjeve të energjisë elektrike.

Sistemi elektroenergjetik në Kosovë vazhdon të mbetet i brishtë dhe jofleksibil përkundër faktit që përparim i konsiderueshëm është bërë në rritjen e qëndrueshmërisë së sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) mbulon afërsisht nëntëdhjetë përqind (90%) të prodhimit vjetor vendor, prodhim i bazuar në termocentrale me linjtë që është ndotës për ambientin. Duke qenë se KEK-u përfaqëson pjesën më të madhe të prodhimit vendor të energjisë elektrike në Kosovë, funksionimi efikas i termocentraleve është kyç për garantimin e sigurisë së furnizimit. Megjithatë, termocentralet në KEK kanë kaluar kohëzgjatjen e tyre të paraparë të funksionimit dhe investimet e nevojshme për zgjatjen e jetëgjatësisë së tyre kanë qenë të kufizuara. Rrjedhimisht, KEK-u rrallëherë operon me kapacitet optimal, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në nivelin e sigurisë së furnizimit në Kosovë. Për më shumë, investimet e kufizuara kanë ndikuar në rritjen e ndotjes së ajrit dhe në krijimin e problemeve mjedisore dhe shëndetësore.

Përparim i konsiderueshëm në sektorin e energjisë është shënuar në aspektin e integritetit regjional. Ndër arritjet më të mëdha konsiderohet Marrëveshja për Kyçe ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT) dhe Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO-E). Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ka mundësuar funksionalizimin e linjës së interkoneksionit katërqind kilovolt (400 kV) ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, fillimin e funksionimit të KOSTT-it si Zonë Kontrolli brenda Bllokut të Kontrollit Shqipëri-Kosovë duke u shkëputur përfundimisht nga Serbia. Mirëpo, për të forcuar më tej sigurinë e furnizimit me energji elektrike, Kosova duhet të zbatojë disa nga masat e reformës së kyçes si: operacionalizimi i bursës shqiptare të energjisë (ALPEX) dega në Kosovë, rritja e kapaciteteve ndërkufitare dhe koordinimi i kapacitetit ndërkufitar me të gjithë Operatorët fqinjë të Sistemit të Transmetimit.

Investimet dhe përgatitjet vazhdojnë për realizimin dhe zgjerimin e gazsjellësit Trans - Adriatik. Vlerësimi i ndërlidhjes ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë tashmë është përfunduar, ndërsa një studim parafizibiliteti për Kosovë-Maqedoninë e Veriut tubacioni është ende në vazhdim. Të dy projektet kanë potencial për të ndihmuar në largimin e energjisë nga qymyri dhe në stabilitetin e rrjetit të energjisë.

Sa i përket tregut të brendshëm të energjisë, vazhdimi i procesit të hapjes së tregut me pakicë për konsumatorët e kyçur në nivel tensioni 35 kV dhe 10 kV do të ndikojë në promovimin e konkurrencës, duke lejuar hyrjen e më shumë furnizuesve në tregun me pakicë dhe zgjerimin e mundësive të zgjedhjes ndërmjet ofertuesve më të mirë për konsumatorët.

Marrë parasysh mangësitë që kanë karakterizuar sektorin e energjisë, është me rëndësi që fokusi tani të jetë tek veprimet në vijim:

- Vazhdimi i përmirësimit të performancës mjedisore të Termocentralit “Kosova B”;
- Zbatimi i masave të Efiçencës së Energjisë në sektorin privat dhe atë rezidencial ;
- Promovimi i burimeve të ripërtëritshme, Efiçienca e Energjisë dhe objektivat e dekarbonizimit;
- Zhvillimi i projekteve të BRE-ve përmes ankandëve dhe skemave tjera konkurruese nxitëse për zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese;
- Përfshirja e çmimeve të karbonit dhe zbatimi i tyre nga viti 2026-të;
- Avancimi i rrjetit të OST-së dhe OSSH-së me qëllim të absorbimit të llojeve të ndryshme të BRE-ve;
- Fuqizimi i rolit të OST-së për çështje të balancimit të sistemit, krijimi i procedurave për shërbime ndihmëse; ndryshimi i kornizës ligjore për qëllime të modernizimit dhe zhvillimit të rrjetit të operatorëve të sistemit;
- Fuqizimi i të drejtave të konsumatorit, zhvillimi i çmimeve konkurruese, përfshirja e dispozitave të reja ligjore që ndërlidhen me të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve aktiv, të drejtat dhe obligimet mbi Komunitetet Qytetare të Energjisë; përcaktimi i masave për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, adresimi i çështjeve të varfërisë energjetike;
- Zgjerimin e rolit të Rregullatorit me qëllim të përshtatjes së objektiveve të reja mbi përfshirjen e projekteve inovative për rezerva, monitorimin e mjetit krahasues për çmime, vlerësimi vjetor i planeve zhvillimore të OST-së dhe OSSH-së dhe të tjera.

Përshkruani gjithashtu nëse KD-ja ndërlidhet me zbatimin e acquis së BE-së

Sektori i energjisë zë një vend të rëndësishëm edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, që ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016¹. Në kuadër të kësaj Marrëveshje, Kosova obligohet, ndër të tjera, që të përmbushë detyrimet që lidhen me njëjtësimin e bazës ligjore dhe zbatimin e saj në nivel të politikave duke përfshirë dhe zbatimin e acquis të energjisë dhe fushave të ndërlidhura siç janë rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

¹ <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>

Detyrimi për të përafruar legjislacionin e Kosovës në sektorin e energjisë me atë të BE-së buron nga neni 74 dhe neni 114 i MSA-së. Neni 74 paragrafi 1 i MSA-së thekson si në vijim:

“Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohet dhe zbatohet siç duhet”.

Në anën tjetër neni 114 i MSA-së paraqet rëndësinë e bashkëpunimit në mes palëve i cili do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit të Energjisë. Neni 114 për Energji i MSA-së potencon që:

“Në përputhje me *acquis* përkatëse të BE-së, Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e energjisë në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të Traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë, i nënshkruar në Athinë më 25 tetor të vitit 2005”. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në Traktatin e themelimit të Komunitetit të Energjisë (TKE), me qëllim integrimin gradual të Kosovës në tregjet evropiane të energjisë.

Gjithashtu, Kosova si Palë nënshkruese e Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë ka për detyrim që të përafrojë dhe zbatojë *acquis* e BE siç parashihet në nenin 10 të Traktatit si në vijim: “Çdo Palë Kontraktuese zbaton *acquis* e BE-së mbi energjinë në përputhje me afatin kohor të zbatimit të këtyre masave të përcaktuara në shtojcën 1”.²

Për më shumë, parashihet mundësia e përfshirjes për ndihmë, për përmirësimin dhe shumëllojshmërinë e furnizimit me energji dhe qasjes në tregun e energjisë, si dhe zbatimin e rregullave të BE-së për transit, transmetim, shpërndarje me vendet fqinjë. Gjithashtu, parashihet edhe zbatimi i *acquis* së BE-së për Eficiencën e Energjisë, Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë.

Në anën tjetër, Programi për zbatimin e MSA-së³, Kapitulli 15, pika 3.15 parasheh në objektivat prioritare afatmesme rishikimin e Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Përveç detyrimeve të MSA-së, Kosova obligohet të përmbushë kërkesat e dala nga Raporti i Komisionit Europian për Kosovën për vitin 2021⁴.

Marrë parasysh se ky Koncept Dokument trajton rëndësinë e ndryshimit të kornizës ligjore në Kosovë ashtu që të përputhet me atë të BE, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, ky dokument ndërlihet drejtpërsëdrejti me zbatimin e *acquis* të BE-së.

Tabela 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i	Lidhja me politikën apo	Institucioni/et	Roli dhe detyrat e
------------	-------------------------	-----------------	--------------------

² <https://www.energy-community.org/legal/treaty.html>

³ http://mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202022-2026_shq.pdf

⁴ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

politikave, ligj ose akti nënligjor.	dokumentin planifikues permes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare.	shtetëror/e i përgjegj/et/ene për zbatim.	Institucionit/eve.
Strategjia e Energjisë për periudhën 2017-2026.	https://me.rks-gov.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_.pdf	Qeveria e Republikës Kosovës Ministria e Ekonomisë	Strategjia e Energjisë ka përcaktuar pesë objektiva strategjike: 1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike; 2. Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë; 3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja; 4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror; 5. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në Eficiencë të Energjisë, Burime të Ripërtëritshme të Energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.
Programi i zbatimit të strategjisë për periudhën 2018-2020.		Qeveria e Republikës Kosovës Ministria e Ekonomisë Ministria e Financave Ministria e Punës Zyra e Rregullatorit të Energjisë Operatori i Transmisionit,	Programi i zbatimit të strategjisë për periudhën 2018-2020 është dokument themelor trevjeçar (3) për zhvillimin e sektorit të energjisë. Ky dokument paraqet aktivitetet e detajuara për zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2026. Në kuadër të programit janë të paraqitur si një listë prej njëzet e shtatë (27) objektivash specifike dhe nëntëdhjetë e shtatë (97) aktiviteteve që janë paraparë të ndërmerren për zhvillimin e sektorit të

		Sistemit dhe Tregut Kompania Kosovare e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike.	energjisë deri në vitin 2020-të.
Ligji Nr.05/081 për Energjinë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12689	Ministria e Ekonomisë	Përcakton parimet e përgjithshme përmes të cilave drejtohen veprimtaritë në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji, për të krijuar kushte për një treg të hapur funksional, transparent dhe konkurrues. Harton politikat e energjisë dhe ka përgjegjësi mbi inspektimin, monitorimin dhe planifikimin e zhvillimit të sektorit të energjisë.
Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744	Ministria e Ekonomisë Zyra e Rregullatorit të Energjisë	Përcakton rregullat dhe masat për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike për të garantuar furnizim të sigurt, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike, me çmime reale, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikas të saj. Përcakton rolin, obligimet dhe përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm në sektor të energjisë.

Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12694	Zyra e Rregullatorit të Energjisë	Përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.
Ligji Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11326	Ministria e Ekonomisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë Ngrohëtorët	Përcakton kushtet për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrencës të energjisë termike për ngrohje/ftohje të përqendruar, sipas ekonomisë së tregut të lirë, mbrojtjes së mjedisit, furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient me energji termike, për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, dhe të tjera.
Ligji Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13319	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Përgjegjës për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve administrative për zbatimin e projekteve strategjike në Kosovë, përfshirë projektet e energjisë.
Ligji Nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2760	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ky ligj përcakton parimet dhe procedurat, kushtet dhe rregullat e përgjithshme për rregullat e autorizimit, monitorimin dhe anulimin e ndihmës shtetërore.

Ligji Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51726	Ministria e Ekonomisë	Roli kryesor është në përcaktimin e caqeve të Eficiencës së Energjisë (EE) dhe arritjen e këtyre caqeve në zbatim të planeve të veprimit për eficiencë të energjisë, zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe masat tjera të Eficiencës së Energjisë (EE).
Ligji Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13176	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Përgjegjës për përcaktimin e kornizës së përgjithshme për metodologjinë kombëtare për llogaritjen e performancës së integruar energjetike të ndërtesave dhe njësive të tyre.

Tabela 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	1. Krijimi i një tregu fleksibil dhe konkurrues për zhvillimin e politikave të cilat ndjekin një ekonomi të pastër duke u mbështetur në një tranzicion të drejtë energjetik. 2. Harmonizimi i akteve ligjore dhe rregullative për t'u përshtatur me dispozitat ligjore në kuadër të Pakos së Energjisë së Pastër. 3. Rritja e investimeve në kapacitetet gjeneruese ekzistuese si dhe përfshirja e procedurave të reja konkurruese për të siguruar skema mbështetëse financiare me qëllim të rritjes së konkurrencës në ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit nga BRE-të. 4. Përditësimi dhe zgjerimi i dispozitave ligjore dhe procedurale për trajtimin e masave emergjente për furnizim me energji elektrike në sektorin e energjisë. 5. Rritja e sigurisë juridike të vendimeve të Rregullatorit nëpërmjet kufizimit të mundësisë së shtyrjes së ekzekutimit të tyre.
Problemi Kryesor	Harmonizimi i legjislacionit aktual të energjisë në përputhje me kërkesat e Pakos së Energjisë së Pastër dhe akteve të tjera të BE.
Shkaqet	1. Njejtësimi i dispozitave ligjore me Pakon e Energjisë së Pastër. 2. Tejkalimi i mangësive të evidentuara në aspektin ligjor dhe rregullativ për vendimmarrje të drejtë ndaj të drejtave themelore të konsumatorëve. 3. Rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike përgjatë viteve 2022-2031.

	4. Mangësitë e evidentuara ligjore në trajtimin e çështjeve emergjente të sigurisë së furnizimit me energji elektrike. 5. Zbatimi i vendimeve administrative dhe pasojat nga shtyrja e ekzekutimit të vendimeve.
--	--

Problemi kryesor

Në vitin 2016-të, Qeveria e Republikës së Kosovës konform obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) mbi transpozimin e dispozitave ligjore, miratoi Pakon e Tretë të Energjisë të përbërë prej katër (4) ligjesh lidhur me sektorin e energjisë elektrike dhe gazit. Baza ligjore e krijuar, hapi rrugën për zhvillimin e akteve të tjera legjislative dytësore nga Rregullatori dhe Ministria përgjegjëse për energjinë, duke përmbushur në tërësi obligimet ligjore. Në këtë mënyrë, Kosova shënoi progres në transpozimin e dispozitave ligjore të Pakos së Tretë të Energjisë, megjithatë, implementimi në praktikë dhe zbatimi i disa reformave kanë ngecur.

Në anën tjetër, në vitin 2021, Komuniteti Energjisë në kuadër të takimit të Këshillit Ministror, ka aprovuar vendimin nr.2021/13/MC-EnC ku Palët Kontraktuese obligohen mbi transpozimin e dispozitave ligjore të Direktivës mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike (BE) 2019/944 Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike BE 2019/941 dhe Rregulloren mbi Qeverisjen në Union të Energjisë dhe Veprimit Klimatik (BE) 2018/1999 në kuadër të legjislacionit primar. Duke marrë parasysh që institucionet në Kosovë obligohen për të transpozuar dhe zbatuar reforma të reja nga Pakoja e Energjisë së Pastër, moszbatimi në praktikë i reformave të vjetra mund të rezultojë me pengesa dhe vonesa eventuale në procese të rëndësishme për sektorin.

Bazuar në përgjegjësitë dhe obligimet që Republika e Kosovës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, detyrohet që të ndryshojë aktet ligjore dhe rregullative në përputhje me Pakon e Energjisë së Pastër. Transpozimi i dispozitave ligjore dhe krijimi i ligjeve të reja do të sigurojë zhvillimin e mëtejshëm të tregut bazuar në objektivat ambicioze të parapara për BRE dhe kërkesave Europiane drejt tranzicionit gradual drejt energjisë së pastër, rritje të konkurrencës, zhvillim të integritetit rajonal, fuqizim të drejtave të konsumatorëve duke i bërë pjesë aktive të tregut, modernizimi i rrjeteve të OST dhe OSSH, zgjerimi i rolit të Rregullatorit duke përfshirë përgjegjësi shtesë monituoruese ndaj konsumatorëve dhe të licensuarve, zhvillimit të projekteve inovative si ruajtja e energjisë, mobiliteti elektrik etj.

Në anën tjetër, rekomandohet zhvillimi paralel dhe me prioritet i politikave të mbetura nga pakoja e tretë e energjisë, marrë parasysh rëndësinë dhe domosdoshmërinë e këtyre reformave për të ardhmen e sektorit energjetik.

Efektet

Republika e Kosovës ka nevojë për një fokus strategjik në një agjendë gjithëpërfshirëse të gjelbër, në përputhje me qëllimet e BE, përfshirë një zhvendosje graduale nga linjiti tek burimet

e ripërtëritshme dhe rritjen e Eficiencës së Energjisë në të gjithë sektorët. Në këtë aspekt, janë evidentuar shkaqet dhe efektet e stagnimit në realizim të disa reformave si në vijim:

1. Në vitin 2016-të, ligjvënësit në Kosovë miratuan një paketë prej tri ligjesh që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë elektrike dhe gazit, me qëllim të përmbushjes së detyrimit të tyre për të transpozuar dispozitat e Pakos së Tretë të Energjisë në ligjet kombëtare. Dispozitat kryesore janë kodifikuar në tre ligje të, përkatësisht, Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë, si dhe në akte të ndryshme nënligjore të nxjerra nga Ministria përgjegjëse për Energjinë dhe ZRrE-në. Krijimi i bazës ligjore ka dhënë rezultate të kënaqshme megjithatë zbatimi i disa reformave ka stagnuar në praktikë. Në mënyrë që të shmangen vonesat eventuale në të ardhmen, identifikimi i qartë i palëve të interesuara dhe caktimi i përgjegjësive të institucioneve të përfshira në procesin e zhvillimit të legjislacionit të ri është i domosdoshëm për arritjen e objektivave të parapara në Pakon e Energjisë së Pastër.
2. Stagnimi i implementimit në praktikë të disa reformave në kuadër të Pakos së Tretë të Energjisë Elektrike mund të vështirësojë zbatimin e legjislacionit të ri konform Pakos së Energjisë së Pastër përmes të cilit do të transpozohen politika të reja dhe të identifikohen masa të reja, të tilla si: rritja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, integrimi i plotë i tregut, tranzicioni- arritja e objektivave drejt dekarbonizimit, efienca e energjisë - reduktimi i emetimeve të gazeve serrë; dhe rritja e nivelit të projekteve inovative dhe konkurrencës. Ndër çështjet kyçe për zhvillim të tregut të brendshëm dhe promovim të konkurrencës vazhdon të mbetet mosliberalizmi i tregut me pakicë për konsumatorët e kyçur në nivel tensioni 35 kV dhe 10 kV. Një ndër efektet kryesore konsiderohet Marrëveshja e Blerjes me shumicë të energjisë elektrike⁵ mes Gjeneruesit vendor dhe Furnizuesit me të drejtë të shërbimit publik si pasojë e së cilës kapacitet vendore nga termocentralet “Kosova A dhe B”, janë të rezervuara ekskluzivisht për konsumatorët në kuadër të FSHU’së. Për më tepër, kjo marrëveshje është duke shkaktuar pengesa në aktivizimin e furnizuesve të tjerë rrjedhimisht mungesës së konkurrencës në tregun me shumicë dhe pakicë. Çështje tjera të rëndësishme të cilat kanë pamundësuar integrimin në tregjet rajonale është mosfunksionalizimi i bursës shqiptare si dhe kontesti mes Kosovës dhe Serbisë për çështje ndërkufitare....
3. Investimet e kufizuara përgjatë viteve të kaluara në kapacitete ekzistuese dhe kapacitete të reja gjeneruese, kanë rënduar sigurinë e furnizimit me energji elektrike duke e bërë të varur nga importi, veçanërisht gjatë muajve të dimrit. Mungesa e mekanizmave që i japin mundësi nxitjes së prodhimit nga BRE, në nivel të konsumatorëve dhe të projekteve me kapacitete të mëdha, ka pasur efekt në krijimin e një sektori më të qëndrueshëm dhe të sigurtë të energjisë elektrike.
4. Viti 2021, karakterizohet si një ndër vitet me pasoja të rënda financiare në sektorin e energjisë në mbarë Europën. Pasojat e krizës energjetike, kanë goditur rëndë sektorin e energjisë në Kosovë duke shkaktuar implikime të mëdha financiare për ndërmarrjet energjetike dhe devijime të theksueshme në rrjetin e transmetimit të Evropës si pasojë e

⁵ <https://me.rks-gov.net/sq/kkdfë-dokumentet-e-privatizimit#.YmvuWe1Bw2w>

mosarritjes së sigurimit të importeve të nevojshme për shkak të çmimeve astronomike. Përkundër faktit që legjislacioni aktual parasheh masat emergjente për furnizim të energjisë elektrike, të njëjta nuk ishin të mjaftueshme duke shkaktuar paqartësi drejt tejkalimit të situatës së krijuar. Zhvillimi i skenareve/planeve të ndryshme për menaxhimin dhe daljen nga krizat e furnizimit me energji elektrike konsiderohet e domosdoshme. Legjislacioni i ri duhet të parasheh hartimin e rregulloreve për parandalimin e rreziqeve që detajojnë veprimet e nevojshme që do të ndërmerren në nivel nacional dhe ndërkufitar për të parandaluar dhe trajtuar krizat potenciale të furnizimit me energji elektrike.

5. Legjislacioni aktual në fuqi parasheh funksionimin e pavarur të Rregullatorit, si nga subjektet private ashtu dhe publike. Shtyerja apo pezullimi i vendimeve të ndryshme të Rregullatorit të Energjisë nga ana e Gjykatave Kompetente, pa udhëzime se si të veprohet gjatë pezullimit, përveç se ndikon në sigurinë juridike të punës së Rregullatorit, mund të shpie drejt rrezikimit të sigurisë së operimit të sistemit, ndikim në marrëveshjet me institucionet tjera ndërkombëtare si dhe arritjet e deritanishme në pavarësimin e sistemit elektroenergetik në Kosovë⁶.

Shkaqet

Komuniteti i Energjisë (KE) ka aprovuar raportin mbi mangësitë ligjore⁷ në kuadër të Pakos së Energjisë së Pastër për sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës. Bazuar në gjetjet nga ana e KE-së rezulton nevoja për hartimin e ligjeve të reja për Palët Kontraktuese duke transpozuar dispozitat ligjore nga direktivat dhe rregullat e Pakos së Energjisë së Pastër deri në fund të vitit 2023. Bazuar në raportin e KE-së, parashihet transpozimi i dispozitave të reja ligjore si pjesë përbërëse e legjislacionit të ri. Arsyt kryesore për hartim të akteve të reja ligjore bazohen si në vijim:

1. Legjislacioni aktual në fuqi duhet të harmonizohet/njejtësohet në përputhje me kërkesat ligjore të Pakos së Energjisë së Pastër. Pakoja e Tretë e Energjisë parasheh objektivat deri në vitin 2020-të, ndërsa Pakoja e Energjisë së Pastër paraqet nevojën për përmbushjen e caqeve për periudhën 2021-2030. Mosimplementimi i dispozitave të reja ligjore dhe objektivave të parapara në kuadër të Pakos së Energjisë së Pastër do të ndikojë në vështirësimin e zbatimit të politikave të reja konform trendeve Europiane si: skemat e reja konkurruese të mbështetjes për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, rritja e nivelit të efikasitetit të energjisë, zgjerimi i rolit të Rregullatorit, zgjerimi dhe fuqizimi i të drejtave të konsumatorit, krijimi i tregut likuid dhe konkurrues, integrimi i plotë rajonal dhe të tjera;
2. Pakoja e Energjisë së Pastër promovon projektet inovative të cilat nuk kanë qenë pjesë përbërëse e legjislacioneve të kaluara e të cilat konsiderohen të nevojshme për rritjen e sigurisë së furnizimit, zhvillimin e tregut konkurrues dhe zvogëlimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike si: ruajtja e energjisë, rritja e kapaciteteve të BRE-ve, krijimi i

⁷ Raporti EnC mbi vlerësimin e mangësive në Republikën e Kosovës 2021

bazës ligjore për mobilitet elektrik, aplikimin e çmimeve konkurruese për konsumatorët, krijimin e platformës për krahasim të çmimeve, përgjegjësia dhe të drejtat e grupeve të qytetarëve dhe bizneseve për të rregulluar prodhimin dhe konsumin e energjisë, fuqizimi rolit të Rregullatorit duke shtuar përgjegjësit mbi monitorimin e aktiviteteve të reja mbi projektet inovative, konsumatorët dhe të licencuarit, adaptimi i planit mbi menaxhimin dhe administrimin e krizave të furnizimit me energji elektrike, krijimi i politikave dhe mekanizmave për bashkëpunim me shtetet anëtare të BE-së në menaxhimin e krizave energjetike dhe të tjera;

3. Sistemi elektoroenergjetik në Republikën e Kosovës, i përbërë nga gjenerimi i energjisë elektrike, transmetimi i energjisë elektrike, shpërndarja e energjisë elektrike dhe furnizuesit, si dhe tregtarët me shumicë, është i dizajnuar kryesisht për të prodhuar energji elektrike e cila bazohet nga linjiti si lëndë e parë, por jo edhe për mbulimin e ngarkesave maksimale dhe balancimin e sistemit i cili mbetet sfidë e madhe për të gjithë pjesëmarrësit në sektor. Pjesa më e madhe e konsumit mbulohet nga prodhimi vendor, por për shkak të vjetërsisë së termocentraleve dhe jofleksibilitetit të mjaftueshëm si dhe kapaciteteve ende të ulëta të BRE-ve për t'iu përshtatur kërkesës në periudha të ndryshme e sidomos në kohën e pikut, paraqitet nevoja për importe por ndonjëherë edhe eksporte për balancimin e sistemit. Në anën tjetër, Kosova është zotuar mbi promovimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme dhe synimin për diversifikimin e miksit të energjisë. Deri në vitin 2020-të, Kosova ka shënuar progres në përmbushjen e caqeve obligative të përcaktuara prej njëzet e pesë përqind (25%), ani pse shumica përfaqësohet nga biomasa dhe sfidë mbetet zhvillimi i proceseve dhe skemave konkurruese për BRE si dhe lehtësimi i procedurave administrative.
4. Gjatë vitit 2021, sektori i energjisë në Kosovë është ndeshur me vështirësi të shumta operationale si pasojë e mangësive ligjore dhe procedurale në trajtimin dhe parandalimin e krizave emergjente për furnizim me energji elektrike. Kriza energjetike është krijuar si pasojë e një kombinimi faktorësh, duke përfshirë rritjen e konsiderueshme të kërkesës për energji elektrike, kapacitete të pamjaftueshme vendore për të mbuluar konsumin dhe kriza globale e energjisë që ka rezultuar në rritje të mëdha të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare
5. Sektori i energjisë në Republikën e Kosovës në vazhdimësi është sfiduar nga aktvendimet të cilat kanë pasur për qëllim shtyerjen apo ndalimin e ekzekutimit të vendimeve të institucioneve të ndryshme energjetike.

Tabela 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së	Shkaku/qet me të cilat	Efekti/et me të cilat	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë
-----------------	------------------------	-----------------------	--

interesuar	është e lidhur pala	është e lidhur pala	shkak /qe apo efekt/in/ et
Ministria e Ekonomisë	1. Njejtësimi/harmonizimi i dispozitave ligjore të legjislacionit aktual me aktet e reja ligjore në përputhje me Pakon e Energjisë së Pastër. 2. Tejkalimi i mangësive të evidentuara në aspektin ligjor dhe rregullativ për vendimmarrje të drejtë ndaj të drejtave themelore të konsumatorëve. 3. Rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike përgjatë viteve 2022-20314. Mangësitë ligjore në trajtimin e çështjeve emergjente të sigurisë së furnizimit me energji elektrike	1. Krijimi i një tregu fleksibil dhe të qëndrueshëm që duke rezultuar në rritje të konkurrencës dhe çmime të favorshme 2. Harmonizimi i legjislacionit aktual të energjisë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga Pakoja e Energjisë së Pastër.. 3. Rritja e investimeve në kapacitetet gjeneruese ekzistuese si dhe përfshirja e procedurave të reja konkurruese duke siguruar skema mbështetëse financiare me qëllim të rritjes së konkurrencës në ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit nga BRE. 4. Përditësimi dhe zgjerimi i dispozitave ligjore dhe procedurale në trajtimin e masave emergjente për furnizim me energji elektrike në sektorin e energjisë	Direkt

Zyra e Rregullatorit për Energji	1. Harmonizimi i legjislacionit aktual me aktet e reja ligjore në përputhje me Pakon e Energjisë së Pastër. 2. Tejkalimi i mangësive të evidentuara në aspektin ligjor dhe rregullativ për vendimmarrje të drejtë ndaj të drejtave themelore të konsumatorëve. 3. Sfidat në sigurimin dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike përgjatë viteve 2022-2031. 4. Mangësitë ligjore në trajtimin e çështjeve emergjente të sigurisë së furnizimit me energji elektrike 5. Zbatimi i vendimeve administrative dhe pasojat nga shtyrja e ekzekutimit të vendimeve.6..	1. 1&2. Harmonizimi i legjislacionit aktual të energjisë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga Pakoja e Energjisë së Pastër, e cila parashtron bazën e nevojshme për implementimin e legjislacionit sekondar. Legjislacioni i ri parasheh dispozita të reja ligjore të cilat sjellin në pah zgjerimin e të drejtave të konsumatorëve por edhe të grupeve të qytetarëve (konsumatorëve) dhe bizneseve për të rregulluar prodhimin dhe konsumin e energjisë, duke i bërë pjesë përbërëse të tregut. 3. Rritja e investimeve në kapacitetet gjeneruese ekzistuese si dhe përfshirja e procedurave të reja konkurruese duke siguruar skema mbështetëse financiare me qëllim të rritjes së konkurrencës në ndërtimin e kapaciteteve të reja të	Direkt/Indirekt
---	--	---	------------------------

		gjenerimit nga BRE. 4. Përditësimi dhe zgjerimi dispozitive ligjore dhe procedurale në trajtimin e masave emergjente për furnizim me energji elektrike në sektorin e energjisë gjatë krizave potenciale energjetike. 5. Rritja e sigurisë juridike të vendimeve të Rregullatorit nepermjet kufizimit të mundësisë së shtyrjes së ekzekutimit të tyre.	
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit	1. Mangësitë ligjore në trajtimin e çështjeve emergjente të sigurisë së furnizimit me energji elektrike.. 2. Harmonizimi i bazës ligjore në përputhje me pakon e energjisë së pastër për trajtimin e çështjeve të pronësisë dhe operimit të sistemeve të ruajtjes së energjisë.	1. Përditësimi dhe zgjerimi i dispozitive ligjore dhe procedurale në trajtimin e masave emergjente për furnizim me energji elektrike në sektorin e energjisë me theks të veçantë përgjegjësitë e Operatorit 2. Implementimi i dispozitive ligjore të cilat trajtojnë dhe qartësojnë pronësisë dhe operimit të sistemeve të ruajtjes së energjisë.	1.Direkt 2.Direkt
Furnizuesi me të drejtë të shërbimit publik	Sigurimia dhe qëndrueshmëria e furnizimit me energji elektrike përgjatë viteve 2022-2031.	1.Investimet e kufizuara në kapacitetet gjeneruese vendore duke shkaktuar pamundësi	Direkt

	Mangësitë ligjore në trajtimin e çështjeve emergjente të sigurisë së furnizimit me energji elektrike.	në sigurimin e furnizimit të nevojshëm për konsumatorët e FSHU. Nevoja për import në kohë të caktuar gjatë pikut dhe muajt e dimrit është e paevitueshme, duke parashtruar nevojën për zgjerimin e kapaciteteve vendore përmes BRE për të mbuluar konsumin vendor dhe zvogëlimin e varshmërisë nga importi. 2.Përditësimi dhe zgjerimi i dispozitave ligjore dhe procedurale në trajtimin e masave emergjente për furnizim me energji elektrike në sektorin e energjisë.	
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	Sfidat në sigurimin dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike përgjatë viteve 2022-2031.	1.Investime të kufizuara në kapacitete gjeneruese ekzistuese	Direkt

Kapitulli 2: Objektivat

Ky Koncept Dokument ofron një përmbledhje të legjislacionit aktual të energjisë dhe opsioneve të ardhshme që po shqyrtohen për të adresuar nevojat e sektorit energjetik të Kosovës dhe përmbushjen e kërkesave të Komunitetit të Energjisë në lidhje me Pakon e Energjisë së Pastër.

Objektiva kryesore është që të hartohet një kornizë e re ligjore dhe rregullative e cila synon arritjen e objektivave të tranzicionit drejt dekarbonizimit, zhvillimit dhe promovimit të

projekteve nga BRE-të, modernizimi dhe zhvillimi i rrjeteve të OST-së dhe OSSH-së, inkurajimin e zhvillimit të projekteve inovative me bazë të llojeve të ndryshme të burimeve të ripërtëritshme, rol të zgjeruar të Rregullatorit, krijimin e planeve për menaxhimin dhe administrimin e krizave të furnizimit me energji elektrike, dhe të tjetra. Për arritjen e qëllimeve të lartëcekura janë paraparë këto objektiva:

Objektiva 1 – Implementimi i politikave të reja të BE-së në kuadër të legjislacionit të ri për energji në përputhje me Direktivën mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike (BE) 2019/944 dhe Rregulloren mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimet Klimatik të Bashkimit Evropian (BE) 2018/1999 me qëllim të arritjes së caqeve të parapara për periudhën 2022-2031 konform mangësive ligjore të identifikuara nga Komuniteti i Energjisë dhe studimet e mëparshme;

Objektiva 2 – Përcaktimi i Autoritetit Kompetent për administrim/vlerësim dhe menaxhim të krizave të furnizimit me energji elektrike në përputhje me kërkesat e Rregullores për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike BE 2019/941 përfshirë krijimi i planeve dhe skenareve për menaxhim të krizave;

Objektiva 3 – Implementimi dhe zbatimi i politikave të reja për fuqizim të rolit të konsumatorit, zgjerim të përgjegjësisë të Rregullatorit dhe të tjera.

Objektivat që synohet të arrihen janë përmirësimi i infrastrukturës ligjore me qëllim të rritjes të promovimit të sigurisë së furnizimit me energji, promovimin e zhvillimit teknologjik dhe inovacioni dhe ofrimi i mundësive për punësim dhe zhvillim rajonal. Prandaj, duke marrë parasysh, obligimet që kemi karshi TKE-së, Kosova duhet të mbështesë masat e zhvillimit kombëtare dhe rajonale në ato zona, të inkurajojnë shkëmbimin e praktikave më të mira në prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe iniciativat e zhvillimit rajonal dhe promovojnë përdorimin e fondeve strukturore në këtë fushë, që është edhe kusht për integrimin në strukturat evropiane.

Tabela 5: Objektivat relevante të Qeverisë së Kosovës

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Përmirësimi i infrastrukturës ligjore me qëllim të promovimit të sigurisë së furnizimit, promovimi i zhvillimit të projekteve inovative dhe teknologjike.	Strategjia e Energjisë Koncept Dokumenti
Përcaktimi i caqeve për objektivat e zbatueshme për periudhën 2021-2030.	Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031.
Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm përmes rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve energjetike dhe Eficiencës së Energjisë (EE). 1.1. Rishikimi i kornizës ligjore dhe politikave	Plani Strategjik Operacional i Qeverisë së Kosovës për ME-së.

energjetike bazuar në dëshmi, në përputhje edhe me legjislacionin acquis e BE-së.	
Masa 5 Zhvillimi i politikave të EE-së dhe BRE-ve në funksion të tranzicionit të gjelbër dhe Masa 6 Reformimi i tregut të energjisë.	Programi për Reforma Ekonomike (PRE).
Kapitulli 15, pika 3.15 parasheh në objektivat prioritare afatmesme rishikimin e Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Përveç detyrimeve të MSA-së, Kosova obligohet të përmbushë kërkesat e dala nga Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2021.	Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (PKZMSA).

Kapitulli 3: Opsionet

Hartimi i kornizës së re ligjore dhe rregullative në përputhje me Pakon e Energjisë së Pastër pritët të krijojë bazën e nevojshme për mbrojtjen e sistemit të energjisë elektrike nga krizat e furnizimit me energji elektrike, rritjen e diversifikimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike, modernizimin e teknologjisë dhe infrastrukturës të rrjeteve të operatorëve të sistemit, rritja e nivelit të partneriteteve të reja rajonale dhe të tjera. Të gjitha këto do të mundësojnë krijimin e një ekonomie të mirëfilltë energjetike dhe do të jenë rrugë për pjesëmarrje të plotë në tregun e energjisë elektrike në BE.

Siç është theksuar në kapitullin 1 të këtij Koncept Dokumenti, korniza ligjore dhe rregullative e energjisë në Kosovë duhet të njejtësohet/harmonizohet me kërkesat e Pakos së Energjisë së Pastër për të adresuar nevojat e sektorit, dhe për të përmbushur obligimet ligjore të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE). Harmonizimi i legjislacionit aktual me dispozitat e reja ligjore në përputhje me Pakon e Energjisë së Pastër do të mundësojë zhvillimin e sektorit të energjisë konform trendeve Europiane e cila është në përputhje edhe me interesat kombëtare. Rrjedhimisht, ekzistojnë tre opsione të mëposhtme që politikëbërësit mund të ndjekin si në vijim:

Opsioni 1- Ruajtja e gjendjes Status -quo (asnjë ndryshim)

Një opsion i tillë i këtij Koncept Dokumenti është që të mos bëhet asnjë ndryshim dhe rrjedhimisht të ruhet status-quo aktuale. Sektori i Energjisë në Kosovë rregullohet nga tri ligje bazë të sektorit të energjisë dhe akte nënligjore që rrjedhin prej tyre. Ky opsion ruan status-quo-në që do të thotë se baza e tanishme ligjore vazhdon të jetë e zbatueshme për institucionet përgjegjëse. Mirëpo, duke marrë parasysh faktin që Pakoja e Energjisë së Pastër inkudron një sërë reformash të reja për të gjitha shtetet anëtare dhe Palët Kontraktuese, objektivat e reja si ato të BRE-ve, eficiencës së energjisë por edhe të tregjeve energjetike për vitin 2030-të duhet të miratohen përmes legjislacionit primar, gjë që padyshim nuk mund të arrihen me opsionin 1.

Opsioni 2 - Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit (Amandamenti i legjislacionit ekzistues)

Ky opsion fokusohet në amandamentimin/përditësimin e legjislacionit ekzistues respektivisht Ligjin për Energji Elektrike, Ligjin për Energji dhe Ligjin për Rregullator të Energjisë duke bërë përmirësimet/adaptimet e dispozitave të reja ligjore konform Pakos së Energjisë së Pastër.

Amandamentimet e nevojshme pritet të mbulojnë objektivat e sektorit në dimensionet të ndryshme, përkatësisht krijimi i bazës ligjore për: përcaktimin e caceve për dekarbonizim, caqet mbi Burimet e Ripërtëritshme dhe Eficiencës së Energjisë, siguria energjetike, konkurrueshmëria në tregun e brendshëm të energjisë, zgjerimi i të drejtave të konsumatorit dhe të tjera. Megjithatë, aktet ligjore në kuadër të Pakos së Energjisë së Pastër, gjegjësisht direktivat dhe rregullat obligative sipas vendimit nr. 2021/13/MC-EnC për Palët Kontraktuese parashohin transpozimin e shumicës së dispozitave ligjore në legjislacionin primar. Si rrjedhojë, hartimi i akteve të reja ligjore konsiderohet më e përshtatshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit të energjisë.

Opsioni 3 – Hartimi i akteve të reja ligjore

Në vitin 2019-të, Bashkimi Europian miratoi Pakon e Energjisë së Pastër e cila përbëhet nga katër (4) direktiva dhe katër (4) rregullore të veçanta. Të gjitha këto akte ligjore janë me rëndësi vendimtare në mënyrë që të mundësojnë integrimin e plotë të tregut, rritjes së pjesëmarrjes së BRE-vë në tregun e energjisë elektrike dhe ka në fokus kryesor të drejtat e konsumatorëve, nëpërmjet vendosjes së këtyre të fundit tashmë jo vetëm si konsumatorë të mirëfilltë, por duke i bërë pjesë përbërës të tregut. Këto akte janë si në vijim:

- Direktiva mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/944;
- Rregullore në Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/943;
- Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/941;
- Rregullore mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimit Klimatik Bashkimi Evropian (BE) 2018/1999;
- Direktiva e Performancës së Energjisë së Ndërtesave Bashkimi Evropian (BE) 2018/844;
- Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme Bashkimi Evropian (BE) 2018/2001;
- Direktiva e Eficiencës së Energjisë Bashkimi Evropian (BE) 2018/2002, dhe
- Rregullore mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë Bashkimi Evropian (BE) 2019/942.

Në vitin 2021, Komuniteti i Energjisë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të Komuniteti të Energjisë nr. 2021/13/MC-Enc ka marrë vendimin mbi transpozimin e akteve ligjore të Pakos së Energjisë së Pastër nga shtetet anëtare të KE-së. Kosova obligohet që deri në fund të vitit 2023 të hartojë legjislacionin e ri gjithëpërfshirës të energjisë duke transpozuar dispozitat ligjore të direktivave dhe rregulloreve si në vijim:

- Direktivën mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/944;
- Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/941;
- Rregullore mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimit Klimatik 2018/1999.

Legjislacioni i energjisë nuk do të përfshijë dispozitat ligjore nga Direktiva 2018/2001 për Promovimin e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme, Direktiva 2018/2002 për Përdorimin e Eficiencës së Energjisë dhe Direktiva 2018/844 për Performancën Energjetike në Ndërtesa pasi të njëjtat janë subjekt i trajtimit në kuadër të ligjeve të veçanta si: Ligji për Burime të Ripërtëritshme, Ligji për Eficiencë të Energjisë, Ligji për Performancë Energjetike në Ndërtesa. Aktualisht, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës janë në proces të hartimit/përditësimit të Koncept Dokumenteve dhe në disa raste edhe ligjeve në përputhje me kërkesat ligjore nga Pakoja e Energjisë së Pastër.

Legjislacioni i ri i energjisë pritet të eliminojë të gjitha pengesat e identifikuar dhe do të hapë rrugën drejt zhvillimit të mtejshëm të sektorit të energjisë në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji dhe zhvillimit ekonomik. Dispozitat ligjore të direktivave dhe rregulloreve si më lartë parashihet të trajtohen në kuadër të tri legjislacioneve primare si në vijim:

- Ligji për Energji Elektrike parasheh krijimin e procedurave administrative dhe transpozimin e akteve ligjore në përputhje me Direktivën mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/944. Ndër të tjera, dispozitat e reja ligjore trajtojnë kryesisht çmimet e furnizimit me energji elektrike të bazuara në treg konkurrues, përgjegjësi të zgjeruara të Rregullatorit për energji, promovimin dhe fuqizimin e të drejtave të konsumatorëve dhe të tjera. Ndër të tjera, aktet e reja ligjore pritet të trajtojnë fushat si në vijim⁸:
 - a. Të drejta të konsumatorëve për kontrata me çmime konkurruese;
 - b. Të drejta të konsumatorëve për ndërrim të furnizuesit dhe përcaktimi i rregullave mbi aplikimin e taksave në raste të ndërrimeve të furnizuesit;
 - c. Të drejtat e konsumatorëve për kontrata përmes agregimit (aggregation);
 - d. Krijimi i platformës për krahasim të çmimeve dhe transpozimi i dispozitave të reja ligjore ku definohen përgjegjësitë dhe obligimet me theks te veçantë për të drejtat e grupeve të qytetarëve (konsumatorëve) dhe bizneseve (komunitete qytetare të energjisë) për të rregulluar prodhimin dhe konsumin e energjisë, adresimi i çështjes së konsumatorëve në nevojë dhe përfshirja e konceptit të varfërisë energjetike, qasjen në rrjet nga ana e aplikuesve të ri, veprimet ligjore mbi modernizimin e rrjeteve të operatorëve;
 - e. Fuqizimi dhe zgjerimi i përgjegjësiave të operatorit të sistemit të shpërndarjes përfshirë nxitjet/incentivat për shfrytëzimin e fleksibiliteti të rrjetit të shpërndarjes, integrimi i mobilitetit elektrik në rrjetin e energjisë dhe promovimi i përdorimit të

⁸ Raporti EnC mbi vlerësimin e mangesive në Republikën e Kosovës 2021, fq.1

teknologjive të reja inovative përfshirë çështja e pronësisë së këtyre teknologjive nga ana e OSSH-së;

- f. Fuqizimi i rolit të operatorit të sistemit të transmisionit lidhur me prokurimin e shërbimeve të balancimit dhe koordinimi me OSSH-të, për të lejuar ruajtjen e energjisë (rezerva);
- g. Përdorimin e sistemeve për ruajtjen e energjisë, operimin dhe pronësinë. Po ashtu përcaktimin e rolit të operatorit të sistemit të transmisionit lidhur me sistemin për ruajtjen e energjisë;
- h. aktiviteti gjithëpërfshirës i fuqisë punëtore në sektor të energjisë, përfshirja gjinore në këtë sektor.

Përpos kësaj, Ligji për Energji Elektrike pritet të trajtoj edhe çështjet që ndërlidhen me Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/941 respektivisht masat e emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Objektiva kryesore e kësaj rregullore është krijimi i planeve dhe skenarëve, respektivisht rregullave të rëndësishme për bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare me qëllim të parandalimit, përgatitjes dhe menaxhimit të krizave të energjisë elektrike⁹.

Rregullorja e re pritet të trajtojë dhe prezantojë dispozita të reja ligjore të cilat do të jenë obligative për t'u trajtuar nga institucionet kyçe të energjisë në vend si në vijim¹⁰:

- Detyrimi për të caktuar një autoritet kombëtar qeveritar ose Rregullatorin si Autoritet Kompetent për kryerjen e detyrave specifike në lidhje me vlerësimin e rrezikut të furnizimit me energji elektrike, gatishmërinë ndaj rrezikut dhe menaxhimin me energji elektrike;
- Kërkesa për të njoftuar Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe Grupin Kordinues për Siguri të Furnizimit si dhe të bëjë publik emrin dhe të dhënat e personit kompetent si përfaqësues i autoritetit kompetent;
- Detyrimet për të bashkëpunuar për identifikimin e skenarëve të krizës rajonale të energjisë elektrike dhe identifikimi i skenarëve të konsoliduar të krizës kombëtare të energjisë elektrike në përputhje me metodologjitë e zhvilluara në nivel evropian;
- Detyrimi dhe procedurat për krijimin e një plani të konsoliduar të gatishmërisë ndaj rrezikut;
- Detyrimet për krijimin e mekanizmave për bashkëpunim dhe ndihmë në menaxhimin e krizës së energjisë elektrike ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- Kushtet dhe kufizimet për zbatimin e masave jotregtare për të siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të energjisë elektrike gjatë menaxhimit të krizave dhe të tjera.
- Ligji për Energji pritet të trajtojë çështjet që ndërlidhen me Direktivën mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/944 dhe Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë

⁹ <https://www.acer.europa.eu/electricity/security-of-supply/risk-preparedness>

¹⁰ Raporti EnC mbi vlerësimin e mangesive ne Republikën e Kosoves 2021, fq.2

Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/94 por do të përfshijë edhe dispozita të caktuara nga Rregullorja mbi Qeverisje në Unionin e Energjisë dhe Veprimin Klimatik 2018/1999. Ky ligj do të përcaktojë mekanizmat dhe përpilimin e dispozitave të qarta mbi përgatitjen e bilancit energjetik, definimi i dispozitave në lidhje me NECP-në si dhe përditësimi i dispozitave për të reflektuar Strategjinë Afatgjatë të energjisë, planet zhvillimore të operatorëve të sistemeve, çështjet pronësore të objekteve energjetike, trajtimi i masave emergjente të sigurisë së furnizimit, definimi i dimensioneve të caktuara për raportim, dhe të tjera.

- Ligji për Rregullator të Energjisë përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji përfshirë krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji. Në kuadër të Pakos së Energjisë së Pastër parashihet rol i zgjeruar dhe fuqizuar i Rregullatorit për Energji në përputhje me Direktivën mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/944 për të reflektuar rolet dhe detyrat e akterëve të ri në treg si në vijim¹¹:
 - a. Monitorimi i ruajtjes së energjisë (rezervave), mjetit për krahasim të çmimeve dhe të tjera;
 - b. identifikimin dhe parandalimi i pengesave për krijimin e komuniteteve energjetike qytetare dhe konsumatorëve aktiv;
 - c. aprovimi i produkteve dhe prokurimi për shërbimet ndihmëse;
 - d. fuqizimi i obligimeve të tjera ekzistuese siç është detyrimi për të vlerësuar çdo vit planet e investimit të operatorëve të sistemit të shpërndarjes dhe transmetimit dhe konsistenca e tyre me planet e zhvillimit të rrjetit të Komunitetit të Energjisë dhe publikimi i të gjitha kostove themelore të përdorura për llogaritjen e tarifave.

Legjislacioni i ri pritet të krijojë një mjedis më të përshtatshëm për investime me theks të veçantë në tërheqjen e investimeve direkte nga jashtë dhe nga diaspora. Angazhimet e marra në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për zhvillimin gjithëpërfshirës të sektorit të energjisë do të jenë në fokus të këtij legjislacioni primar të energjisë.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela e mëposhtme tregon ndikimet më të rëndësishme të cilat janë identifikuar në kuadër të secilit option në të ardhmen. Anekset e më poshtme paraqesin ndikimet e identifikuara mbi çështjet ekonomike, sociale, mjedisore dhe të të drejtave themelore.

Më poshtë është një diskutim i shkurtër i llojeve të ndikimeve që rezultojnë nga tre optionet:

Opsioni 1: Ruajtja e gjendjes Status -quo (asnjë ndryshim)

Një option i tillë i këtij Koncept Dokumenti është që të mos bëhet asnjë ndryshim dhe rrjedhimisht të ruhet status-quo aktuale. Sektori i Energjisë në Kosovë rregullohet nga tri ligje

¹¹Raporti EnC mbi vlerësimin e mangësive në Republikën e Kosovës 2021, fq.1 dhe 3

bazë të sektorit të energjisë dhe akte nënligjore që rrjedhin prej tyre. Ky opsion ruan status-quo-në që do të thotë se baza e tanishme ligjore vazhdon të jetë e zbatueshme për institucionet përgjegjëse. Mirëpo, duke marrë parasysh faktin që Pakoja e Energjisë së Pastër inkuadron një sërë reformash të reja për të gjitha shtetet anëtare dhe Palët Kontraktuese, objektivat e reja si ato të BRE-ve, eficiencës së energjisë por edhe të tregjeve energjetike për vitin 2030-të duhet të miratohen përmes legjislacionit primar, gjë që padyshim nuk mund të arrihen me opsionin 1

Tabela 6 : Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara (opsioni 1)
Ndikimet ekonomike	Mospërbushja e objektivave drejt integrimit të plotë rajonal dhe zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese pritet të rezultojë me mungesë të konkurrencës dhe investimeve të reja.
Ndikimet shoqërore	Ndikim në çështjet e arsimit për shkak të pamundësisë së zhvillimit të projekteve/trajtimeve me theks të veçantë në certifikimin e nstallesve të BRE-ve dhe projekteve inovative. Gjithashtu ndikim pritet të ketë në aspektin shëndetësor për shkak të ndikimit të gjenerimit vendor të bazuar në linjit në shëndetin e qytetarëve.
Ndikimet mjedisore	Linjiti do të vazhdojë të përdoret si burim primar i energjisë, duke dëmtuar më tej mjedisin dhe Kosova nuk do të mund të përmbushë kërkesat që rrjedhin nga BE-ja.
Ndikimet në të drejtat themelore	Pamundësia në çasje të avancuara të dhënave të konsumatorëve dhe furnizim i paqëndrueshëm i energjisë elektrike.
Ndikimi gjinor	Nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë, megjithatë vendi do të humbasë mundësitë për punësime shtesë me theks të veçantë në sektorin e burimeve të ripërtëritshme, tregut të de-rregulluar (zhvillimit të konkurrencës) duke minimizuar në këtë mënyrë mundësitë për zhvillim dhe punësim të femrave.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikim direkt
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë, megjithatë vendi do të humbasë mundësitë për punësime shtesë tek të rinjtë me theks të veçantë në sektorin e burimeve të ripërtëritshme, eficienta e energjisë, modernizimi i rrjeteve të OST-së dhe OSSH-së, zhvillimi i projekteve inovative.
Ndikimet në ngarkesën	Ngarkesa administrative parashihen në kuadër të licencimit për aktivitete të ndryshme tek Rregullatori; ngarkesat administrative të

administrative	aplikuara nga OST-ja dhe OSSH-ja në përputhje me Metodologjitë e Taksave për Kyçe dhe të tjera.
Ndikimi i NMV-ve	Mungesa e bazës së mirëfilltë ligjore do të pamundësojë dhe kufizojë nivelin e investimeve në sektorin e energjisë.

Opsioni 2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit (amandamentimin e legjislacionit aktual)

Opsionit 2 do të rezultojë në përditësimin e disa prej dispozitave ligjore sipas Pakos e Energjisë së Pastër duke përmbyshur objektivat e dekarbonizimit, krijimit të një tregut më dinamik të energjisë dhe përgaditjes më të mirë institucionale për kriza eventuale të furnizimit me energji elektrike. Megjithatë ky opsion konsiderohet i pamjaftueshëm për të krijuar bazën e mirëfilltë ligjore për krijimin e një sistemi elektroenergjetik të qëndrueshëm dhe besueshëm konform Pakos së Energjisë së Pastër dhe sipas nevojave të sistemit në të ardhmen, me theks tek implementimi i projekteve të mëdha të ruajtjes së energjisë

Ky opsion mund të konsiderohet si një mjet i mirëfilltë testues në aspektin e zhvillimit të tregut me qëllim të vlerësimit të shkallës së interesimit/disponimit që kanë investitorët e huaj për të investuar në Kosovë.

Tabela 7: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara (opsioni 2)
Ndikimet ekonomike	Ndikime pozitive në drejtim të rritjes së mundësive të punësimit, rritje të konkurrencës në mes të akterëve të ndryshëm në sektor por edhe bizneseve, rritje në cilësinë e produkteve të bizneseve dhe të tjera.
Ndikimet shoqërore	Rritja e disponueshmërisë dhe besueshmërisë së energjisë së gjeneruar nga burime të ndryshme të energjisë së pastër do të rezultojnë në rritjen e nivelit edukative dhe shëndetësore për shoqërinë duke krijuar një mjedis të mirëfilltë në vend.
Ndikimet mjedisore	Përqëndrimi drejt zhvillimit të projekteve të bazuara nga burimet e ndryshme të energjisë së ripërtëritshme dhe zvogëlimit të moderuar të përdorimit të qymyrit, vendi do të ketë ndikime pozitive në mjedis dhe do të jetë në gjendje të përmbyshë kërkesat e BE-së.
Ndikimet në të drejtat themelore	Si rezultat i gjenerimit të energjisë elektrike përmes teknologjisë së pastër, pritet të zvogëlohen emetimet e CO ₂ nga termocentralet.
Ndikimi gjinor	Si rezultat i rritjes së mundësive të punësimit në vend, si sektori publik ashtu edhe industria private në Kosovë do të kenë mundësi të

	konsiderueshme për të zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse gjinore për rekrutimin, mbajtjen dhe promovimin e fuqisë punëtore, duke rezultuar kështu në një ndikim të përgjithshëm pozitiv gjinor në vend.
Ndikimet e barazisë sociale	Me një qasje të përmirësuar gjithëpërfshirëse gjinore, barazia sociale do të sigurohet, si dhe përfshirja në serinë e plotë të zhvillimit, menaxhimit dhe funksionimit të sektorit të energjisë, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.
Ndikimet tek të rinjtë	Si rezultat i një industrie të zgjeruar të energjisë, do të ketë mundësi të shumta për të rinjtë në Kosovë që të marrin pjesë në mundësitë arsimore dhe punësimin në sektorin e energjisë.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Ngarkesa administrative parashihen në kuadër të licencimit për aktivitete të ndryshme tek Rregullatori; ngarkesat administrative të aplikuara nga OST-ja dhe OSSH-ja në përputhje me Metodologjitë e Taksave për Kyçe dhe të tjera.
Ndikimi i NMV-ve	Opsioni do të ketë një ndikim pozitiv në NVM-të megjithatë nuk do të jetë i mjaftueshëm si pasojë e bazës së mangët ligjore.

Opsioni 3: Hartimi i akteve të reja ligjore

Ky opsion parashtron nevojën për hartimin e akteve të reja ligjore për Energji Elektrike, Energji dhe Rregullator të Energjisë. Ky legjislacion i ri i cili do të miratohet nga Kuvendi do të themelojë bazën për krijimin e një sistemi modern për konsumatorët dhe investitorët, si dhe do të përshpejtonte integrimin e plotë të Kosovës në tregjet rajonale dhe diversifikimin e miksit të energjisë në përputhje me angazhimet ndërkombëtare.

Miratimi i akteve të reja ligjore do të ndikojë në përshpejtimin e tranzicioni energjetik marrë parasysh objektivat ambicioze të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, të iniciohet një rritje më dinamike në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe të zbatohen sisteme moderne stimuluese në këtë fushë.

Tabela 8: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuar për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuar (opsioni 3)
Ndikimet ekonomike	Ndikime shumë pozitive në drejtim të rritjes së mundësive të punësimit, rritje të konkurrencës në mes të akterëve të furnizuesve dhe tregtarëve, pjesëmarrje e madhe e konsumatorëve në tregun konkurrues duke rritur nevojën për punësime shtesë, rritje në cilësinë e produkteve të biznesve, rritje të numrit të investitorëve dhe të tjera.

Ndikimet shoqërore	Si rezultat i investimeve të konsiderueshme në sektorin e energjisë, industria do të kërkonte punëtorë të aftë dhe të trajnuar, që do të rriste mundësitë për zhvillimin e aftësive dhe aftësimin profesional. Për më shumë zhvillimi i industrisë me fokus në energji të pastër dhe trajtimi i kategorive të konsumatorëve në nevojë do të rriste dobietë edukative, sociale dhe shëndetësore për shoqërinë dhe do të krijonte një mjedis të mirëfilltë.
Ndikimet mjedisore	Përqëndrimi drejt zhvillimit të projekteve të bazuara nga burimet e ndryshme të energjisë së ripërtëritshme dhe zvogëlimit të moderuar të përdorimit të qymyrit, vendi do të ketë ndikime pozitive në mjedis dhe do të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e BE-së.
Ndikimet në të drejtat themelore	Si rezultat i gjenerimit të energjisë elektrike përmes teknologjisë së pastër, pritët të zvogëlohen emetimet e CO2 nga termocentralet.
Ndikimi gjinor	Si rezultat i rritjes së mundësive të punësimit në vend, si sektori publik ashtu edhe industria private në Kosovë do të kenë mundësi të konsiderueshme për të zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse gjinore për rekrutimin, mbajtjen dhe promovimin e fuqisë punëtore, duke rezultuar kështu në një ndikim të përgjithshëm pozitiv gjinor në vend.
Ndikimet e barazisë sociale	Me një qasje të përmirësuar gjithëpërfshirëse gjinore, barazia sociale do të sigurohet, si dhe përfshirja në serinë e plotë të zhvillimit, menaxhimit dhe funksionimit të sektorit të energjisë, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.
Ndikimet tek të rinjtë	Si rezultat i një industrie të zgjeruar të energjisë, do të ketë mundësi të shumta për të rinjtë në Kosovë që të marrin pjesë në mundësitë arsimore dhe punësimin në sektorin e energjisë.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Ngarkesa administrative parashihen në kuadër të licencimit për aktivitete të ndryshme tek Rregullatori; ngarkesat administrative të aplikuara nga OST-ja dhe OSSH-ja në përputhje me Metodologjitë e Taksave për Kyçe dhe të tjera.
Ndikimi i NMV-ve	Ky opsioni do të ketë një ndikim shumë pozitiv në NVM-të në dy mënyra. Së pari, NVM-të do të jenë në gjendje të planifikojnë biznesin e tyre dhe të bëjnë investime të reja me më pak rreziqe duke pasur parasysh besueshmërinë e disponueshmërisë së energjisë së re. Së dyti, disa nga NVM-të ekzistuese, si dhe investitorë të rinj, do të kenë mundësinë të investojnë në biznese të reja energjetike. Si rezultat, ndikimi i përgjithshëm në NVM-të pritët të jetë shumë

pozitiv.

Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi punues nuk ka hasur në sfida të theksueshme në aspektin e mbledhjes së të dhënave për hartimin e këtij Koncept Dokumenti. Si problem i veçantë mund të konsiderohet kriza energjetike që ka kapluar mbarë Evropën në vitin 2021 e cila ka goditur rëndë edhe sektorin e energjisë në Kosovë. Gjithashtu problemet e vazhdueshme të pandemisë COVID-19 vazhdojnë të jenë prezente në vend duke pamundësuar pjesëmarrjen në takime apo vonesat eventuale në dorëzimin e të dhënave.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Në këtë kapitull është paraqitur plani i aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit për këtë Koncept- Dokument. Pjesa më e madhe, e palëve të brendshme të interesuara si KOSTT-i, ZRrE-ja dhe KEK-u janë pjesë e grupit punues dhe kanë hartuar apo janë konsultuar gjatë hartimit të dokumentit. Informimi, komunikimi dhe konsultimi me palët e interesuara përgjatë çdo procesi të rëndësishëm në sektor të energjisë konsiderohet pjesë kyçe në mënyrë që çdo iniciativë të rezultojë e suksesshme. Ministria e Ekonomisë do të duhet të konsiderojë iniciativat drejt angazhimit të palëve të interesuara që do të përfshinte gjatë procesit të hartimit të koncept -dokumentit si:

- Shoqëria civile;
- Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorëve;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Oda Ekonomike e Kosovës përfshirë Odat tjera për mbrojtje të interesave të bizneseve;
- Shoqatat për Burime të Ripërtërishme për Energji dhe agjencitë tjera për BRE;
- Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit;
- Industria – kompanitë e përfshira në aktivitete të mëdha;
- NMV-të (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme);
- Shoqatat e industrisë,
- Akademia,
- Donatorët,
- Media,
- Të tjerë.

Tabela 9: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një Koncept-Dokument (Kjo pjesë plotësohet pas fazës së Konsultimeve paraprake dhe Publike)

Procesi i konsultimit synon: - [jepni informacionin këtu] -						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara.	Të gjitha palët e interesuara.	Takim publik.				
Konsultimi publik me shkrim.	Të gjitha palët e interesuara.	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik.				

Kapitulli 6: Krahasoni opsioneve

Opsioni një (1) konsiderohet që nuk është adekuat për të adresuar problemet e identifikuar në këtë Koncept Dokument. Ky opsion do ta bënte të pamundur zbatimin e masave për përmbushjen e objektivave në sektor të energjisë. Opsioni një (1) pa asnjë ndryshim do të ruante status-quo-në dhe ndikimi i efekteve do të vazhdonte.

Opsioni i dytë (2) parasheh amandamentimin dhe përmirësimin e politikave aktuale, përkatësisht ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore aktuale konform Pakos së Energjisë së Pastër. Mirëpo, ky plotësim/ndryshim konsiderohet i pamjaftueshëm proceduralisht për të trajtuar të gjithë nevojat ligjore që do të mundësonin adresimin e problemit kryesor.

Si rrjedhojë, opsioni i dytë (2) konsiderohet që nuk është i përshtatshëm për përmbushjen në tërësi të objektivave të parapara dhe nevojitet një bazë ligjore më e fortë për të rregulluar sektorin në përgjithësi dhe për të adresuar të gjitha veprimet që duhet të autorizohen me ligj. Gjithashtu, kompetencat dhe zgjerimi i përgjegjësive të palëve të ndryshme të interesit duhet të përcaktohen me ligj në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe duke marrë parasysh përvojat e shteteve tjera kontraktuese.

Opsioni i tretë (3) paraqet nevojën për hartimin e Ligjit për Energji Elektirke, Ligjit për Energji dhe Ligjit për Rregullator të Energjisë në përputhje me Pakon e Energjisë së Pastër gjegjësisht Direktivës 2019/944 Rregullës 2019/941 dhe Rregullës 2018/1999 në përputhje me Vendimin e Këshilit Ministror të Komuniteti të Energjisë nr.2021/13/MC-EnC të datës 30 nëntor 2021.

Opsioni i tretë (3) krijon bazën e nevojshme ligjore dhe adreson problemet kryesore në sektorin e energjisë. Hartimi i akteve të reja ligjore do të sigurojnë bazën e nevojshme ligjore për

përmbushjen e objektivave energjetike gjithëpërfshirëse në sektor duke pasur parasysh nevojat për energji, me theks të veçantë në autorizimet që do të përcaktoheshin me dispozita ligjore.

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Tabela më poshtë paraqet planin e zbatimit për opsionin dy (2)

Tabela 10: Plani i zbatimit për Opsionin dy (2)

Qëllimi i politikës	Përditësimi dhe azhurnimi i legjislacionit aktual të energjisë respektivisht Ligjit për Energji, Ligjit për Energji Elektrike dhe Ligjit për Rregullator të Energjisë në përputhje me dispozitat ligjore të Direktivës mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/944, Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/941 dhe Rregullorja mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimet Klimatik Bashkimi Evropian (BE) 2018/1999.							Shifra e koston e pritur
Objektivi strategjik	Amandamenti i legjislacionit aktual në fuqi.							
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës.							
Objektivi Specifik 1 Miratimi i ligjeve të energjisë	Produkti 1.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës
			2022	2023	2024	2025	2026	
		Aktiviteti 1.1.1 Konsulti me paraprak e me Ministrinë relevante dhe palët e		X				Ministria e Ekonomisë

		interesit.							
		Aktiviteti 1.1.2 Dorëzimi i ligjeve të amandamentuara /përditësuar me të gjitha dokumentet përcjellës e për miratim në Qeveri.		X				Ministria e Ekonomisë	
		Aktiviteti 1.1.3 Miratimi i ligjeve të përditësuar me të gjitha dokumentet përcjellës e nga Qeveria.		X				Qeveria e Republikës së Kosovës	
		Produkti 1.2	Amandamentimi i akteve nënligjore (dytësore)						
			Viti 1 2022	Viti 2 2023	Viti 3 2024	Viti 4 2025	Viti 5 2026	Institucioni /departamenti përgjegjës	

		Aktiviteti 1.2.1 Amanda mentimi i rregullave e dytësore.			X	X		ME, ZRrE	
Objektivi Specifik 2	Produkti 2.1 Aprovimi i rregullave të përditësuar.	Rregulla për kushtet e përgjithshme të furnizimit me Eficiencë të Energjisë (EE).				X		ME, ZRrE	
	Produkti 2.2 Aprovimi i rregullave të përditësuar.	Rregulla për shkyçje dhe rikyçje, Rregulla për përdorim të mjetit krahasues për çmime Rregulla për Ankesa dhe zgjidhje të Konteste etj.				X		ME, ZRrE	

[Përmbledhni shkurtimisht Opsionin 3. Përshkruani se si ky opsion trajton problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e identifikuara në Pemën e Problemit].

Tabela 11: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Implementimi dhe zbatimi i politikave të reja të BE-së për të përmbushur objektivat e përcaktuara në përputhje me Direktivën mbi Rregullat e Përbashkëta për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/944, Rregulloren për Gatishmërinë ndaj Rrezikut në Sektorin e Energjisë Elektrike Bashkimi Evropian (BE) 2019/941, Rregulloren mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimet Klimatik Bashkimi Evropian (BE) 2018/1999 me fokus në zhvillimin dhe krijimin e një sektori të qëndrueshëm të energjisë elektrike, i bazuar në energji të pastër dhe i përshtatshëm për tërheqjen e investimeve.							Shifra e pritshme e kostos
	Implementimi i dispozitave ligjore europiane është në linjë me procesin e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian (BE). Pakoja e Energjisë së Pastër promovon projektet e energjisë së ripërtëritshme, inovative dhe të modernizuara e të cilat pritet të kontribuojnë në përmbushjen e zotimeve të Qeverisë karshi BE për diversifikimin e miksit të energjisë dhe zvogëlimin e emetimeve të CO2 dhe gazrave tjerë serrë në përputhje me acquis të BE.							
Objektivi strategjik	Hartimi i politikave dhe mekanizmave të reja ligjore dhe rregullative në përputhje me Pakon e Energjisë së Pastër dhe në harmoni me trendet dhe përvojat evropiane.							
	Si rrjedhojë, pritet të krijohet baza e nevojshme për mbrojtjen e sistemit të energjisë elektrike nga krizat e furnizimit me energji elektrike, rritjen e diversifikimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike, modernizimin e teknologjisë dhe infrastrukturës së operatorëve të sistemit, rritja e nivelit të partneriteteve të reja rajonale dhe të tjera. Të gjitha këto do të mundësojnë krijimin e një ekonomie të mirëfilltë energjetike dhe rrugës për pjesëmarrje të plotë në tregun e energjisë elektrike në Bashkimin Evropian							
Objektivi specifik 1	Produkti 1.1	Hartimi i akteve të reja ligjore: Ligji për Energji, Ligji për Energji Elektrike dhe Ligji për Rregullator të Energjisë						
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti

			2022	2023	2024	2025	2026	përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1.1 Konsultimet parapra- ke me Ministri- në relevan- te dhe palët e interesit		X				Ministria e Ekonomisë	
		Aktiviteti 1.1.2 Dorëzimi i ligjeve të reja me të gjitha dokume- ntet përcjell- ëse për miratim në Qeveri.		X				Ministria e Ekonomisë	
		Aktiviteti 1.1.3		X				Qeveria e Republikës së Kosovës	

		Mirati mi i ligjeve të reja me të gjitha dokume ntet përcjell ëse nga Qeveria							
	Produkti 1.2	Hartimi i akteve nënligjore (dytësore)							
			Viti 1 2022	Viti 2 2023	Viti 3 2024	Viti 4 2025	Viti 5 2026	Institucioni /departame nti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.2.1 Hartimi i rregulla ve dytësor e			X	X		ME, ZRrE	
Objektivi specifik	Produkti 2.1 Aprovimi i Rregullave dytësore.	Rregull a per kushtet e përgjith shme të furnizi mi me EE,			X			ME, ZRrE	

		Plani mbi menaxhminin e krizave.							
	Produkti 2.2 Aprovimi i Rregullave dytësore.	Rregulla për shkyçje dhe rikyçje, Rregulla për përdorim të mjetit krahasues për çmime , Rregulla për Ankesa dhe zgjidhje të Kontestave etj.			X				
Objektivi specifik	Produkti N.1	Etj.							

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

[Jepni një paraqitje të shkurtër narrative të tre opsioneve. Gjithashtu paraqitni opsionin e zgjedhur dhe arsyet kryesore përse është zgjedhur].

Tabela 12: Krahasimi i opsioneve

Metoda e krahasimit:			
Ndikimet relevante pozitive	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit (Amandamenti legjislativ ekzistues).	Opsioni 3: Hartimi i akteve të reja ligjore
Standard më i lartë i edukimit dhe hulumtimit.	jo	pjesërisht	plotësisht
Kuadro më të përgatitura për tregun e punës, mundësi më të mira të bërit biznes.	jo	pjesërisht	plotësisht
Ngritje e produkteve inovative.	jo	pjesërisht	plotësisht
Konkurrueshmëri me rajonin.	jo	pjesërisht	plotësisht
Ndikimet relevante negative			
Kosto			
Rezultate të paqëndrueshme.			
Kostot relevante			

Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Përfundimi									

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Qeveria e Kosovës ka bërë të qartë synimin e saj për të krijuar kushtet drejt një zhvillimi afatgjatë e të qëndrueshëm. Njëri nga bazat e një zhvillimi të këtillë është sektori energjetik. Ky sektor ngelet njëri ndër pararendësit kryesor të zhvillimit ekonomik dhe ndikimi i tij shtrihet në mjedis dhe shëndetin e qytetarëve. Rrjedhimisht, zhvillimi i qëndrueshëm lidhet drejtpërsëdrejti me dekarbonizimi sa më të shpejtë të sektorit energjetik.

Dekarbonizimi përveç se paraqet një orientim strategjik të Qeverisë së Kosovës, rrjedh edhe nga anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Traktatin e Themelimit të Komunitetit të Energjisë. Si anëtare, institucionet shtetërore të Kosovës kanë për obligim që të njëjtësojnë bazën ligjore të brendshme të sektorit të energjisë me atë të Bashkimit Evropian (BE). Ngjashëm, ky obligim rrjedh edhe nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim që rregullon marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian (BE).

Megjithëkëtë, Kosova ballafaqohet me probleme të konsiderueshme të sektorit të energjisë. Varshmëria në termocentrale të vjetërsuara të linjitet vazhdon të ngelet e lartë, kurse pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme në prodhimin e përgjithshëm vendor të energjisë duhet të përmirësohet. Rritja e shpejtë e kapaciteteve të reja të gjelbra të energjisë dhe siguria e furnizimit me energji janë disa nga sfidat kryesore të Qeverisë duke marrë parasysh nivelin e investimeve që do të nevojiten dhe ngritjen e kapaciteteve teknike të rrjeteve të energjisë elektrike për të absorbuar këtë lloj të energjisë.

Në vitin 2019-të, BE-ja përmbylli diskutimet rreth pakos së re të legjislacionit të energjisë, e njohur si Pakoja e Energjisë së Pastër, dhe dispozitat morën karakter obligues për shtetet anëtare. Pakoja e Energjisë së Pastër konfirmoi tutje përkushtimin e BE-së ndaj një ekonomie karbon-neutrale dhe, si rezultat, është reflektuar në objektiva të reja që shtrihen tek zvogëlimi i mëtejshëm i gazrave serrë, përfaqësimi i lartë i burimeve të ripërtëritshme në miksin energjetik, dhe ngritja e Eficiencës së Energjisë (EE). Për t'i arritur këto objektiva, një sërë instrumente të reja politikash janë paraparë, siç janë planet e integruara klimatike dhe të energjisë, theks i veçantë për të drejtat e grupeve të qytetarëve dhe bizneseve për të rregulluar prodhimin dhe konsumin e energjisë, dhe rritja e kapaciteteve teknike të rrjetit energjetik.

Me vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të energjisë, shtetet anëtare obligohet që të transpozojnë disa nga dispozitat e kësaj Pakoje. Afati për ta përmbushur këtë obligim është viti 2023. Transpozimi i këtyre dispozitave do të jetë i dobishëm për ballafaqimin dhe përmirësimin e situatës në sektor. Për më tepër, Kosova do të respektojë obligimet e saj ndaj Komunitetit të Energjisë.

Rrjedhimisht, opsioni i rekomanduar nga ky Grup është ai që parasheh hartimin dhe aprovimin e një pakoje të re ligjore të sektorit të energjisë. Nëpërmjet këtij opsioni, sigurohemi se krijohet një bazë ligjore e qëndrueshme dhe sipas praktikave më të avancuara në Evropë. Ky veprim do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në tërheqjen e investimeve për rritjen e kapaciteteve të pastra të energjisë dhe, afatgjatë, në kualitetin e jetës së qytetarëve. Për më tepër, ky legjislacion do t'i hap rrugën përcaktimit të objektivave të reja të dekarbonizimit dhe t'i bëjë ato dispozita të obligueshme në nivel shtetëror.

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Monitorimi është një element i rëndësishëm gjatë implementimit të politikave të reja në çdo sektor. Mekanizimi i monitorimit dhe vlerësimit ndihmon në identifikimin e përdorimit në mënyrë më të dobishme dhe efikase të burimeve të ndryshme të energjisë në dispozicion. Për më tepër, konsiderohet si element kyç për zhvillimin e objektivave të ndryshme dhe sukseset potenciale.

Monitorimi dhe vlerësimi i objektivave në kuadër të legjislacionit të ri të energjisë, pritet të performohen nga ana e Ministrisë dhe Zyra e Rregullatorit për Energji në varësi të përgjegjësisë mbi objektivën e caktuar.

Disa nga caqet kryesore indikative që do të përdoren gjatë monitorimit dhe vlerësimit të këtij koncepti- dokumenti janë:

- Zbatimi i politikave dhe kërkesave ligjore;
- Trajnim dhe/ose nevoja shtesë për personel;
- Ndikimet socio-ekonomike;
- Ndikimet në Mjedis;
- Zbulimi i informacionit publik / konsultimet e dokumentit;
- Komunikimi i ndryshimeve të mundshme me audiencën e synuar etj.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ¹²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?	Po		Lartë	Lartë	
Bërja e biznesit	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?	Po		Lartë	Lartë	

	A do të detyrohen bizneset të mbyllën?		Jo	Ulet	Ulet	
	A do të krijohen biznese të reja?	Po		Lartë	Lartë	
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?	Po		Lartë	Lartë	
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?	Po		Lartë	Lartë	
	A pritjet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?	Po		Lartë	Lartë	
Tregtia	A pritjet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?	Jo		Ulet	Ulet	
	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?	N/A				
Investimet	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?	N/A				
	A pritjet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?	Po		Lartë	Lartë	
	A pritjet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		Jo	Ulet	Ulet	
	A do të rriten investimet nga diaspora?	Po		Lartë	Lartë	

	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		Jo	Ulet	Ulet	
	A do të rriten investimet e huaja direkte?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		Jo	Ulet	Ulet	
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?	Po/Jo		Lartë	Lartë	
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		Jo	Ulet	Ulet	
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?	Po		Lartë	Lartë	
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		Jo	Ulet	Ulet	
	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?	Po		Lartë	Lartë	
Ndikimi në NVM	Çmimet dhe konkurrenca			Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për konsumatorët?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për		Jo	Ulet	Ulet	

	biznesin apo konsumatorët?						
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?	Po/Jo		Lartë		Lartë	
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		Jo/Po	Ulët		Ulët	
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	Po					
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		Jo				
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	Po					
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?	Po					

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitim i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ¹³	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	Po		Lartë	Lartë	
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		Jo	Ulët	Ulët	
Kushtet e	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	Po		Lartë	Lartë	

punës	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezykshme?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	Po		Lartë	Lartë	
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?	Po		Lartë	Lartë	
Përfshirja sociale	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		Jo			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?	Po		Lartë	Lartë	
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë	Po		Lartë	Lartë	

jetës?							
Kultura	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?	Po		Lartë		Lartë	
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		Jo				
	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?	N/A					
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?	N/A					
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?	N/A					
Qeverisja	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?	N/A					
	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?	Po		Lartë		Lartë	
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	Po		Lartë		Lartë	
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	Po		Lartë		Lartë	
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?	N/A					

	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?	Po		Lartë	Lartë	
Shëndeti dhe siguria publike ¹⁴	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë: nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në	N/A				

	ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?						
	A ka grupe të vecanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si moshë, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?	N/A					
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	N/A					
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?	N/A					
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?	N/A					
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	N/A					
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?	N/A					

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj)?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?	Po		Lartë	Lartë	
Cilësia e ajrit	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		Po	Lartë	Lartë	
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?	Jo		Ulët	Ulët	

	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?	Jo		Ulet	Ulet	
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?	Jo		Ulet	Ulet	
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?	Jo		Ulet	Ulet	
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?	Jo		Ulet	Ulet	
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj)?		Jo	Ulet	Ulet	
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj)?		Jo	Ulet	Ulet	
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?	Po		Lartë	Lartë	
Mbeturinat dhe rreklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?	Po		Lartë	Lartë	
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?	Po		Lartë	Lartë	

	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?	Po		Lartë	Lartë	
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj)?	Jo		Ulet	Ulet	
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj)?	Jo		Ulet	Ulet	
	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?	Jo		Ulet	Ulet	
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?	Jo		Ulet	Ulet	
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?	Jo		Ulet	Ulet	
	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?	Jo		Ulet	Ulet	
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?	Jo		Ulet	Ulet	
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e	Jo		Ulet	Ulet	

	specieve në një zonë të caktuar?					
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		Jo	Ulët	Ulët	
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		Jo	Ulët	Ulët	

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
			Jo	Ulët	Ulët	
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		Jo	Ulët	Ulët	
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		Jo	Ulët	Ulët	

	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?	Jo	Ujë	Ujë	
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	Jo	Ujë	Ujë	
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrëgjim dhe kundërshtim të garantuara?	Jo	Ujë	Ujë	
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	Jo	Ujë	Ujë	
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?	Jo	Ujë	Ujë	
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?	Jo	Ujë	Ujë	
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?	Jo	Ujë	Ujë	
	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	Jo	Ujë	Ujë	
Trajtimi i barabartë	A ka gjasë që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi	Jo	Ujë	Ujë	

	seksual)?						
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?	Jo	Ulet		Ulet		
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?	Jo	Ulet		Ulet		
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?	Jo	Ulet		Ulet		
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj)?	Jo	Ulet		Ulet		
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?	Jo	Ulet		Ulet		
	A ndikohet qasja në drejtësi?	Jo	Ulet		Ulet		